VENDIM
Nr. 793, datë 24.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E KATEGORISË NGA PUNONJËSIT KËRKIMORË-SHKENCORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 25, të ligjit nr. 109/2024, "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për përfitimin e kategorisë nga punonjësit kërkimorë-shkencorë, "asistent kërkues-shkencor", "kërkues-shkencor", "kërkues-shkencor i avancuar" dhe "drejtues kërkimor-shkencor", të instituteve dhe të njësive të veçanta të kërkimit shkencor, të krijuara sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Për përfitimin e kategorisë "asistent kërkues-shkencor", kandidati duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave", në fushën përkatëse të arsimimit, ose një diplomë të barasvlershme me të, në përputhje me nivelin e shtatë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast se diploma është lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, ajo duhet të jetë njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të jetë i regjistruar dhe në ndjekje të programit të studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

c) të ketë referenca nga dy ekspertë të fushës së tij të angazhimit në veprimtari të kërkimit shkencor, të cilët zotërojnë tituj akademikë.

3. Për përfitimin e kategorisë "kërkues-shkencor", kandidati duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast zotërimi të një diplome të lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, të jetë e njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të ketë zhvilluar veprimtari kërkimore-shkencore, të paktën 1 (një) vit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", e cila vërtetohet nëpërmjet angazhimit në veprimtari kërkimore-shkencore në institucione të arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit shkencor;

c) të ketë botuar, së paku, 1 (një) artikull shkencor në revista ndërkombëtare të indeksuara, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

ç) të ketë botuar, së paku, 2 (dy) artikuj shkencorë, në revista kombëtare të kategorisë A ose B, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

d) të ketë referenca nga 2 (dy) ekspertë të fushës së tij të angazhimit në veprimtari të kërkimit shkencor, të cilët zotërojnë tituj akademikë.

4. Për përfitimin e kategorisë "kërkues-shkencor i avancuar", kandidati duhet:

a) të zotërojë kategorinë "kërkues-shkencor";

b) të zotërojë diplomë të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast zotërimi të një diplome të lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, të jetë e njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të ketë zhvilluar veprimtari kërkimore-shkencore prej të paktën 3 (tre) vjet, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", e cila vërtetohet përmes angazhimit në veprimtari kërkimore-shkencore në institucione të arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit shkencor;

ç) të ketë botuar, së paku, 2 (dy) artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të indeksuara, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

d) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë, në revista kombëtare të kategorisë A ose B, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

dh) të ketë pjesëmarrje në veprimtari kërkimore-shkencore, si pjesëmarrje në komitete shkencore apo udhëheqje ose bashkëudhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit-shkencor.

5. Për përfitimin e kategorisë "drejtues kërkimor-shkencor", kandidati duhet:

a) të zotërojë kategorinë "kërkues-shkencor i avancuar";

b) të zotërojë diplomë të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", niveli i tetë i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në rast zotërimi të një diplome të lëshuar nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, të jetë e njohur dhe njësuar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

c) të ketë zhvilluar veprimtari kërkimore-shkencore prej të paktën 5 (pesë) vjet, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", e cila vërtetohet përmes angazhimit në veprimtari kërkimore-shkencore në institucione të arsimit të lartë, institute apo njësi të veçanta të kërkimit shkencor;

ç) të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të indeksuara, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

d) të ketë botuar, së paku 4, (katër) artikuj shkencorë, në revista kombëtare të kategorisë A ose B, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor";

dh) të ketë pjesëmarrje në veprimtari kërkimore-shkencore, si pjesëmarrje në komitete shkencore apo udhëheqje ose bashkëudhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë, institute ose njësi të veçanta të kërkimit-shkencor.

6. Kandidati për përfitimin e kategorisë së punonjësit kërkimor-shkencor aplikon pranë institutit kërkimor-shkencor ose njësisë së veçantë të kërkimit shkencor.

7. Instituti kërkimor-shkencor ose njësia e veçantë e kërkimit shkencor ngre një komision të posaçëm të vlerësimit të dosjeve (në vijim "KVD") për vlerësimin e aplikimeve. KVD-ja, nëse e vlerëson të nevojshme, fton personel të kategorisë "Profesor" nga universitetet publike, për shqyrtimin e aplikimeve.

8. KVD-ja shqyrton aplikimin brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, sipas kritereve të parashikuara për secilën kategori.

9. Në rast të përmbushjes së kritereve, KVD-ja i përcjell për vlerësim Këshillit Shkencor aplikimin.

10. Pas vlerësimit, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga Këshilli Shkencor, drejtuesi i institutit kërkimor-shkencor vendos për dhënien e kategorisë për aplikantin.

11. Kur aplikimi për përfitimin e kategorive nga kandidatët bëhet pranë njësisë së veçantë të kërkimit shkencor, funksionin e Këshillit Shkencor e kryen Këshilli Shkencor i institutit kërkimor-shkencor, me të cilin njësia e veçantë e kërkimit shkencor ka lidhur marrëveshje për këtë qëllim.

12. Drejtuesi i institutit kërkimor shkencor përkatës lëshon aktin e miratimit të kategorisë, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga vlerësimi i Këshillit Shkencor, për përfitimin e kategorisë përkatëse për punonjësin kërkimor-shkencor.

13. Kategoria e përfituar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, mund të transferohet në institutin ose në njësinë e veçantë kërkimore-shkencore, brenda së njëjtës fushë të kërkimit shkencor.

14. Procedura e ankimimit bëhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

15. Për institutet ose njësitë e veçanta kërkimore-shkencore, të cilat krijohen për herë të parë, kategoritë e punonjësve kërkimorë-shkencorë do të përcaktohen nga institutet ekzistuese, sipas fushës së kërkimit shkencor që ato mbulojnë, ose, në rast të mungesës së tyre, do të jepen nga drejtuesi i njësisë kryesore në institucione të arsimit të lartë, lloji "universitet", që kanë të drejtë të japin tituj dhe mbulojnë fushën përkatëse të kërkimit shkencor.

16. Kandidatët që gëzojnë gradën shkencore "Doktor" dhe provojnë nëpërmjet dokumentacionit, që kanë ushtruar veprimtari në fushat përkatëse të kërkimit shkencor për më shumë se 5 (pesë) vjet, e përfitojnë kategorinë "kërkues-shkencor i avancuar" ose "drejtues kërkimor-shkencor", pa përmbushur përcaktimet e shkronjës "a", të pikës 4, dhe të shkronjës "a", të pikës 5, të këtij vendimi.

17. Kandidatëve që zotërojnë titujt akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", në rast të angazhimit në institutin e kërkimit shkencor ose në njësi të veçantë të kërkimit shkencor u caktohet kategoria "drejtues kërkimor-shkencor", pavarësisht kritereve të përcaktuara në këtë vendim.

18. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku